





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Klan Kosova  
Barlet Imami  
Drejtor  
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2024/12– Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Klan Kosova  
(Pala Përgjegjëse)

Faktet

1. KPM me datë 21 dhjetor 2023 ka miratuar Rregulloren KPM-2023/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale. Kjo Rregullore ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e programeve të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe moral, mbrojtjen e fëmijëve gjatë përfshirjes së tyre në përmbajtje mediale, me fokus të veçantë mbrojtjen e fëmijëve të cenueshëm, si dhe mënyrën e kategorizimit, sinjalizimit dhe kohën e transmetimit të programeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mendor, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
2. Me datë 24 nëntor 2023, KPM mori Vendim që Pala përgjegjëse të sanksionohet me gjobë në shumë prej pesëmijë (5.000) euro për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03.
3. KPM, ka bërë monitorimin ex-officio të Palës përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM 2023/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale, lidhur me transmetimin e Prime Big Brother Vip Kosova 2 dhe të emisionit Big Talk përmbajtjeve programore të cilat mund të jenë të dëmshme për fëmijë dhe të mitur. Monitorimi është bërë për tri (3) ditë, 19, 21 dhe 22 janar 2024.
4. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 23 janar 2024 ka gjetur se Pala përgjegjëse me datat 19, 21 dhe 22 janar 2024 ka transmetuar “Prime Big Brother Vip Kosova 2 dhe “Big Talk” para kohës së paraparë me rregullore (nga ora 24:00-06:00) dhe nuk ka ndërmarr veprimet teknike të kodimit me pin/kod, ashtu siç është e përcaktuar me Rregullores KPM-2013/01.
5. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datë 25 janar 2024 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar që të veproj në pajtim me Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM 2023/01, duke i ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh të përgjigjen dhe të ofrojnë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e lartpërmendura.

6. KPM ka pranuar përgjigje me datë 2 shkurt 2024 Pala përgjegjëse, përmes të cilës thekson se për të dëshmuar se kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura brenda mundësive tona teknike, është rasti i rubrikës apo përmbledhjes ditore ( emisionit) të “Big Brother Vip Kosova 2”, e cila para hyrjes në fuqi të rregullores së re është transmetuar për çdo ditë, hënë e premte në kohën 18:20 min deri 18:55 min mirëpo, me hyrjen në fuqi të rregullores së re KPM-2023/01 përmbledhjen ditore të (emisionit) të “Big Brother Vip Kosova 2”, e kemi larguar nga transmetimi dhe skema programore me faktin që të jemi në harmoni me rregulloren e re. Ndërsa çështja e transmetimit të Prime para kohës së paraparë me rregullore, është krejtësisht çështje teknike e cila assesi nuk varet nga vullneti i transmetuesit dhe produksionit, përkatësisht nga dep. teknik i transmetuesit të Palës përgjegjëse, për arsye se këtë veprim duhet dhe mund ta marrin të gjithë operatorët kabllor, pra përgjegjësia e ndërmarrjes së veprimeve teknike të kodimit të Prime bije mbi gjithë OSH-të. Kurse me përmendjen e emisionit Big Talk, ju njoftojmë se emisioni në fjalë është një emision i rëndomtë si edhe të gjitha emisionet e tjera argëtuese ( pra nuk është reality show ) në të cilin emision ftohen shumë mysafirë dhe opinionistë, përkatësisht njohës të mirë të show – bizit të cilët analizojnë dhe komentojnë ngjarjet aktuale të show bizit. Ndërkaq Prime dhe Big Talk, për gjithë këtë kohë kanë qenë emisione të kontrolluara, të planifikuara dhe të menaxhuara deri në detaje për të mos lejuar asnjë shkelje të gjuhës, përmbajtjes apo ngjashëm.
7. KPM, ka gjetur se Pala përgjegjëse edhe përkundër Vendimit sanksionues të KPM-së të datës 24 nëntor 2023 ka dështuar të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2023/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale.

#### Analiza ligjore

8. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 6, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM 2023/01.
9. KPM bazuar në Raportin e monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse ka transmetuar programe Reality Show në mënyrë të pa koduar para kohës së paraparë me Rregulloren KPM-2023/01, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 6, të Rregullores KPM 2023/01 i cili përcakton se:

*“Programet e formatit shfaqje reale televizive (reality show ose reality TV), njoftimet e transmetimit të tyre, si dhe programet që tregojnë pasqyra të ngjarjeve në ato përmbajtje, shënohen me 18+ dhe mund të transmetohen vetëm në periudhën nga ora 24:00 deri në 06:00. Ky kufizim nuk zbatohet për përmbajtjen e shfaqur me mbrojtje teknike (kodim me pin).”*

10. Transmetimi i programeve Reality Show në bazë të nenit 7, paragrafi 6 të Rregullores KPM 2023/01, pa mbrojtje teknike, mund të behet vetëm nga ora 24 deri në ora 06:00 dhe se përjashtimisht transmetimi i këtij formati mund të behet edhe para orës 24:00 nëse zbatohen masat mbrojtëse teknike (pin/kodi). Pretendimi i Palës përgjegjëse se kodimi nuk mund të behet nga televizioni por nga operatorët e shpërndarjes nuk paraqet arsyetim të bazuar ligjor dhe nuk krijon hapësirë ligjore që këto formate të transmetohen para kohës se lejuar, sepse këto formate në parim nuk duhet të transmetohen para orës 24:00. Transmetimi para orës 24:00 paraqet përjashtim nga zbatimi i normës dhe është i kushtëzuar me kodimin e kanalit (mbetet



nën përgjegjësin e televizionit sigurimi i mekanizmave për kodimin e kanalit, në të kundërtën përmbajtjet e tilla nuk mund të transmetohen para orës 24:00).


11. KPM si rrethanë rënduese për Palën përgjegjëse ka konsideruar edhe Vendimin sanksionues të KPM-së të datës 24 nëntor 2023 për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03, i cili edhe përkundër këtij Vendimi ka dështuar të veproj në pajtueshmëri edhe me Rregulloren KPM-2023/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale.
12. KPM bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka transmetuar programe Reality Show para kohës së kufizimit në mënyrë të pa koduar, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 6, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM 2023/01.

### Vendim

13. Pala Përgjegjëse, sanksionohet me **Gjobë** në shumë prej dhjetëmijë (10 000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 pika 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 7, paragrafi 6, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM 2023/01;
14. Pala përgjegjëse, obligohet që në të ardhmen të ketë kujdes në lidhje transmetimin e programeve të formatit Reality përmbajtje të cilat mund të transmetohen vetëm në periudhën 24:00 deri në 06:00 si dhe obligohet që të ndërmarr veprimet teknike të kodimit me pin/kod ashtu siç është e përcaktuar me nenin 7, paragrafi 6, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM 2023/01.
15. Pala Përgjegjëse obligohet që gjobën në shumë prej dhjetëmijë (10 000) euro e përcaktuar nga pika 13 e këtij vendimi, ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, në xhironlogarinë e KPM-së numër: 1000400070001635.
16. Në rast se Pala Përgjegjëse nuk e paguan gjobën brenda afatit të përcaktuar në pikën 15 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme në procedurë përmbartimore.

### E drejta për ankesë

17. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
18. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjrisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

  
Jeton MEHMETI  
Kryetar



15.04.2024  
Datë